



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDËTËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-834
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 17 -
Date: Datum: Date:	06.02.2017
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

Datë	06.02.2017
Numri i referencës	MSH/DSHB/mgj/ /2017
PËR/ZA/TO:	Te gjithë Udhëheqësit e NjShB-ve Te gjithë Kryeinfermieret e NjShB-ve Te gjithë Drejtorëve te Burgjeve Dr. Hedije Maloku, Udhëheqëse e NjShB ne Prishtine
CC:	Dr. Imet RRAHMANI, Ministër i Shëndetësisë Znj. Dhurata HOXHA, Ministre e Drejtësisë Z. Ardian MEHMETAJ, UD, Sekretar i Përgjithshëm i MSh Z. Sokol ZOGAJ, Drejtor i ShKK/MD
PËRMESPREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Dr. Milazim H. GJOCAJ, Dr. Sci. Udhëheqës i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, Ministria e Shëndetësisë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Hapësirat dhe Pajisjet për Njësite Shëndetësore te Burgjeve

Te nderuar,

Bashkëlidhur me këtë shkresë po ju dërgoj e cila përcakton “Hapësirat dhe Pajisjet Medicinale te Institucioneve Shëndetësore ne Burgjeve”.

Faqe 1 nga 2

Përcaktimi i këtyre standardeve është ne vazhden e implementimit te UA 052014 te QRK mbi funksionimin e shërbimeve shëndetësore ne Burgje me vendim 02/201 te datës 22.10.2014, si dhe realizmit te planit te punës se DShB mbi ngritje e cilësisë se shërbimeve shëndetësore ne burgje.

Bazuar ne këtë vendim, MD ka për obligim qe te garantoj hapësirat për institucione shëndetësore ne burgje dhe te mirëmbajë ato sipas standardeve te MSh.

MSh ka për obligim qe te siguroj stafin, shërbimet, barërat dhe pajisjet.

Bazuar ne këto, janë hartuar specifikat sipas standardeve te MSh, akteve ligjore dhe nënligjore te MSh lidhur me këto specifika.

Këto specifika pritet te implementohen ne periudhën prej 12 muaj deri ne 24 muaj.

Hapësirat dhe pajisjet janë ekuivalente me institucionet shëndetësore publike dhe private dhe me këtë synohet te arrihet integrim i plote dhe të ofrohen shërbime ekuivalente për te burgosurit sikurse për qytetaret e tjerë.

Po ashtu me këtë standardizim, lehtësohet çështja e monitorimit dhe te vlerësimit te kapaciteteve dhe nivelit te shërbimeve shëndetësore qe ofrohen për te burgosurit ne burgje.


Standardizimi si i tille, është edhe kërkesë e Këshillit te Evropës dhe bazohet ne Rregullat Evropiane te Burgjeve.

Shpresoj ne mbështetjen dhe bashkëpunimin tuaj për arritjen e këtyre standardeve.

Me respekt!

Ju faleminderit për mirëkuptim

Me respekt!





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria- Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgje

Në mbështetje të nenit 17, artikullit 6 (6.1; 6.2; 6.3; 6.4), nenit 35, artikullit 1, 2, dhe 3 të Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L-156 ; ne mbështetjeje te nenit 4, artikujt 1, 2, dhe 3; nenit 8, artikujt 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, neni 11, artikulli 1 të Udhëzimit Administrativ mbi funksionimin e shërbimeve shëndetësorë të burgjeve Nr 05/2014 i QRK-se, si dhe bazuar ne UA Nr. 09/2014, UA Nr. 03/2007 te Ministrisë se Shëndetësisë, Drejtori i DShB, përcakton specifikat për:

**HAPËSIRAT, KUSHTET DHE PAJISJET MEDICINALE TË
INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE NË BURGJE**

Qëllimi

Me këtë akt përcakton kushtet e përgjithshme dhe specifike për hapësirat, kushtet dhe pajisjet e nevojshme medicinale për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në institucionet shëndetësor te burgjeve.

Fushëveprimi

Këto specifika janë obligativ për te gjitha institucionet shëndetësor te burgjeve. Te gjitha këto kriteret duhet te plotësohen ne periudhën prej 12 deri ne 24 muaj¹. Përgjegjëse për implementimin e këtyre specifikave janë MD dhe MSh bazuar ne nenin 4, artikulli 2 (2.3; 2.6)) të Udhëzimit Administrativ mbi funksionimin e shërbimeve shëndetësorë të burgjeve Nr 05/2014 i QRK-së.

¹ Përfshirë bene Institucioni për trajtimin e personave me nevoja te veçanta i cili duhet te themelohet sipas Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, (neni 17 artikulli 6);

Institucionet shëndetësore në burgje

1. Institucionet shëndetësore ne burgje, sipas Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, (neni 17 artikulli 6), janë:

2.1. **Ambulanca e burgut;** Ambulanca e burgut përbehet nga këto elemente:

- 2.1.1. Ambulanca specialistike sipas UA 09/2014 te MSh-se.
- 2.1.2. Ambulanca pECIALISTIKE e Mjekësisë Familjare, sipas specifikave te burgut dhe UA/09/2014².
- 2.1.3. Ambulancës stomatologjike³
- 2.1.4. Shërbimit psikologjik ose psikologjik klinik.
- 2.1.5. Shërbimit konsultativ psikiatrik.
- 2.1.6. Shërbimit farmaceutik doracak specifik.
- 2.1.7. Shërbimit laboratorik biokimik dhe hematologjik specifik bazik.

2.2. **Stacionari i burgut;** Stacionari i burgut përbehet nga këto elemente:

- 2.2.1. Ambulancën e burgut sipas specifikave (2.1).
- 2.2.2. Shërbimi konsultativ kardiologjik
- 2.2.3. Shërbimi konsultativ ortopedik*⁴
- 2.2.4. Shërbimi konsultativ për Otorinolaringologji – ORL*
- 2.2.5. Shërbimi konsultativ internistik pulmologjik*
- 2.2.6. Shërbimi konsultativ radiologjik*
- 2.2.7. Shërbimi konsultativ urologjik *
- 2.2.8. Shërbimi fiziatrik dhe fizioterapeutik*
- 2.2.9. Shërbimi i oftalmologjisë *
- 2.2.10. Shërbimi konsultativ i kirurgjisë*
- 2.2.11. Shërbimi bazik i urgjencës
- 2.2.12. Shërbimet e tjera kryhen ne dhoma te sigurta ne Spitale dhe QKUK

2.3. **Institucioni shëndetësor për trajtimin e personave me nevoja të veçanta**⁵; përmban këto njësi:

- 2.3.1. Njësia për trajtimin e personave me nevoja te veçanta (10);
- 2.3.2. Njësia gerontologjike (20),
- 2.3.3. Njësia për trajtim te shtuar mental (15),
- 2.3.4. Njësia për trajtimin e personave me sëmundje te varësisë, (25):
- 2.3.5. Njësia për trajtimin e sëmundjeve kronike (25)

2.4. **Institucioni shëndetësor për kujdesin e nënës dhe fëmiut dhe për te mitur,** përbehet nga këto elemente:

- 2.4.1. Ambulanca specialistike sipas UA 09/2014 te MSh-se.
- 2.4.2. Ambulanca specialistike e Mjekësisë Familjare, sipas specifikave te burgut dhe UA/09/2014.

² Specifikat janë te precizuara ne këtë dokument.

³ Ne ato NjShB ku ka kushte, indikacione dhe hapësirë.

⁴ Shërbimet nga 2.2.3 deri ne 2.2.10 kryhen vetëm ne Stacionarin e Dubraves.

⁵ Ky institucion duhet te ndërtohet dhe nuk mund te realizohet ne përdhën e parapare.